



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1224/Prot

Gjirokastrë, më 19.02. 2024

**LËNDA: RAPORT PËR VEPRIMTARINË E KËSHILLIT TË BASHKISË PËR VITIN
2023 DHE TRASPARENCËN NË PROCESIN E VENDIMMARRJES**

Të nderuar këshilltarë!

Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarrës i qeverisë bashkiake, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë, si dhe duke përdorur me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet burimet njerëzore, financiare, fizike e natyrore, duke punuar bazuar në parimet e interesit public, integritetit, objektivitetit, përgjegjshmërisë, transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit.

Këshilli i Bashkisë Gjirokastrë, gjatë vitit 2023 ka patur si qëllim miratimin e vendimeve që i përkasin shërbimit ndaj qytetarëve, zhvillimit të qytetit, mbështetjes dhe promovimit të turizmit me ndihmë ekonomike dhe vendimet me karakter ekonomik që kanë të bëjnë me:

1. Zbatimin e buxhetit për vitin 2023, projektet e propozuara nga ekzekutivi për përmirësimin e shërbimeve dhe investimet.
2. Ka marrë vendim çdo muaj për dhënie ndihme financiare, për familje, jo vetëm nga fondi i kushtëzuar, por edhe nga të ardhurat e Bashkisë Gjirokastrë si më poshtë :

Nr.	Muaji	Ndihmë ekonomike për familje nga të ardhurat e Bashkisë	Ndihmë ekonomike nga Fondi i kushtëzuar 6 %	për i
1.	Janar	39	10	
2.	Shkurt	40	10	
3.	Mars	37	11	
4.	Prill	38	11	

5.	Maj	42	11
6.	Qershor	41	11
7.	Korrik	40	12
8.	Gusht	40	12
9.	Shtator	37	11
10.	Tetor	38	11
11.	Nëntor	34	11
12.	Dhjetor	34	11

Krahas këtyre vendimeve janë miratuar vendime për :

- Dhënie me qira të tokave bujqësore me qira, lista e sipërfaqeve kullimore dimërore dhe verore, me qëllim mirëmenaxhimit të tyre dhe përdorimin e këtyre tokave në dobi të fermerëve dhe zhvillimit të bujqësisë.
- Shtesë dhe ndryshime të buxhetit për vitin 2023 me qëllim rritjen e efikasitetit të burimeve financiare dhe përdorimin e tyre në shërbim të komunitetit, zhvillimit urban dhe rural, rritjes së investimeve dhe mbështetjes së ekzekutivit në projektet e fituar me fonde të BE, Qeverisë, Fondit Amerikan të Zhvillimit të Bashkimit Evropian Qeverisë Shqiptare dhe donatorë të huaj.
- Buxhetin e vitit 2023 dhe projekt-buxhetin afatmesëm të Bashkisë Gjirokastrë për vitet 2023-2025.
- Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në bashkinë Gjirokastrë për vitin 2023.
- Dhënie e titujve “Qytetar Nderi bazuar në kërkesat dhe trajtimin e dy komisioneve.
- Bursat për nxënësit e arsimit parauniversitar dhe konviktet e shkollave të mesme profesionale, për vitin shkollor 2022-2023 , si dhe mbështetjen e nxënësve ekselentë të APU

etj

Për periudhën janar – dhjetor 2023 janë marrë 115 vendime në Këshillin Bashkiak Gjirokastrë.

- Vlen për tu theksuar se nga 115 vendime të marra 46 vendime kanë kërkuar konfirmimin e Prefektit të Qarkut nga të cilët 45 vendime janë konfirmuar dhe një është kthyer, konkretisht VKB Nr.110 datë 14.12.2023 “Për dhënie të sipërfaqeve të tokave bujqësore dhe kullimore me qira”, cili pas plotësimeve të kërkuara nga instancioni i Prefektit të Qarkut u kalua në mbledhjen e datës 31.01.2024.
- Vendimet me karakter normativ kanë pasur të bëjnë me buxhetin dhe zbatimin e tij, përmirësimin e shërbimeve, detajimin e shpërndarjes së buxhetit etj..

- dhënien e tokave me qira, mbështetjen e projekteve të fituara nga ekzekutivi, planet vendore për pastrimin, mbrojtjen nga zjarri, planet sociale të bashkisë si dhe vendimet për mbështetjen e familjeve që kanë patur dëmtime të banesave të tyre nga zjarri.
- vendimet të cilat janë me karakter personal, 24 prej tyre kanë të bëjnë me dhënien e ndihmës ekonomike sipas muajve , vendime për procesin e privatizimit të banesave për lidhjen e kontratave para noterit, për banesat e para viteve 90, vendime për miratimin e listës së përfituesve të subvencionit të qirasë dhe subvencionit të kredisë, vendime për shtyrjen e afatit të kredisë si dhe për vendosjen në Shtëpinë e të Moshuarve si dhe titujt e nderit.
- 12 vendime me karakter jo normativ janë vendime që kanë të bëjnë me procedurat e zhvilluara për mbledhjen Konstituimit të Këshillit Bashkiak të dalë nga zgjedhjet e 14 majit dhe në mbledhjen pasardhëse për ngritjen e komisioneve.
- Për vitin 2023 janë dhënë 8 tituj “Qytetar Nderi “, 6 prej të cilëve janë dhënë për nderimin e mësuesve dhe figurave të shquara të arsimit me rastin e 100 vjetorit të gjimnazit “ Asim Zeneli”.

Këto vendime të këshillit, flasin qartë për bashkëpunimin e Këshillit me administratën e Bashkisë për t’iu përgjigjur në kohë dhe sipas legjislacionit në fuqi gjithë shqetësimeve dhe problematikave të komunitetit të qytetit të Gjirokastrës dhe njësisve administrative.

Këshilli gjatë kësaj periudhe ka qënë mjaft aktiv, duke mbajtur mbledhje te radhës, mbledhje jashtë radhe, sipas tabelës së mëposhtëme :

Muaji	Nr. mbledhjeve	Mbledhje radhës	Mbledhje jashtë radhe
Janar	2	1	1
Shkurt	1	1	0
Mars	1	1	0
Prill	1	1	0
Maj	1	1	0
Qershor	1	1	0
Total 6 mujor parë	7	6	1
Korrik	2	2	0
Gusht	1	1	0
Shtator	1	1	0
Tetor	1	1	0
Nëntor	2	1	1
Dhjetor	3	2	1

Total 6 mujor dytë	10	6	4
---------------------------	-----------	----------	----------

Periudha	Nr mbledhjeve	Mbledhje radhës	Mbledhje jashtë rradhe
6 mujori parë	9	6	3
6 mujori dytë	10	6	4
Total 12 mujori	19	12	7

Gjatë vitit 2023 janë zhvilluar online 2 prej mbledhjeve jashtë radhe me qëllim arritjen e afateve .

Vlen për tu përmendur se pjesëmarrja e këshilltarëve ka qënë aktive si në mbledhjet e komisioneve ashtu dhe në procesin e vendimmarrjes në mbledhjet plenare online apo ato fizike . Komisionet e përhershme të këshillit janë mbledhur për të diskutuar dhe miratuar projekt vendime te sjella nga administrata e Bashkisë Gjirokastrë që kanë të bëjnë sidomos me vendimet me karakter ekonomik dhe në dhënien e pronave me qira ,titujt e nderit, çeshtje juridike etj

Për periudhën 12-mujore janë bërë 16 mbledhje të komisioneve.

Nr.	Muaji	Mbledhjet e Komisioneve të Përhershëm
1.	Janar	2
2.	Shkurt	1

3.	Mars	2
4.	Prill	1
5.	Maj	2
6.	Qershor	0
Total 6 mujori I-rë	8	
7.	Korrik	1
8.	Gusht	1
9	Shtator	1
10	Tetor	2
11	Nëntor	2
12	Dhjetor	2
Total 6 mujori II-të	9	
TOTALI 12 MUJOR	17	

Nga karakteri i vendimeve mund t'i ndajmë në vendime për:

- 1. financiare**
- 2. sociale**
- 3. infrastrukturën dhe strehimin**
- 4. problemet urbane dhe asetet**
- 5. emergjencat civile**
- 6. probleme të arsimit kulturës**
- 7. trajtimi i mbetjeve**
- 9. planet lokale**

Në zbatim të rregulloreve të miratuara është vënë në funksionim regjistri fizik i ankesave/kërkesave dhe një regjistër fizik i iniciativave/peticioneve ku regjistrohen dhe evidentohen të gjitha ankesat/kërkesat e mbëritura në drejtim të Këshillit të Bashksië. Konkretisht janë depozituar në total 6 kërkesa drejtuar këshillit Bashkiak Kërkesat janë trajtuar dhe janë koordinuar me ekzekutivin e bashkisë dhe në të gjitha rastet janë informuar qytetarët.

Është pasuruar faqja online e Këshillit Bashkiak me informacione për publikum nëpërmjet kartelave të mëposhtëme :

Rreth Këshillit Bashkiak

Struktura e Këshillit Bashkiak

Anëtarët e Këshillit Bashkiak

Vendime të Këshillit Bashkiak.

Komisionet e Kwshillit

Regjistri elektronik i kërkesave, ankesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare.

Është rritur niveli I tranaparencës së këshillit.

Vendimet e Këshillit, procesverbalet e mbledhjeve, njoftimet dhe rendi i ditës janë transparente dhe qytetarët mund t'i gjejnë në ndërfaqen e Këshillit te ëebi i Bashkisë.

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar si dhe ligjit 146/2014. **“Për konsultimin Publik”** gjatë periudhës 12-mujore të këtij viti, Këshilli në bashkëpunim me ekzekutivin marrë pjesë në 12 dëgjesa publike që kanë të bëjnë me hartimin e Paketës Fiskale për vitin 2024, me zbatimin e buxhetit për vitin 2023 dhe kërkesat buxhetore për vitin 2024, përsa i përket miratimit të sistemit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2024, të

buxhetit të Bashkisë Gjirokastrër për vitin 2024 si dhe projekt-buxhetit afatmesëm të Bashkisë Gjirokastrër për vitet 2024-2026.

Këshilli ka marrë pjesë në seanca dëgjimore së bashku me administratën e Bashkisëku janë mbajtur shënime mendimet dhe opinionet e pjesëmarrësve dhe i janë përcjellë Komisionit të Ekonomisë, Buxhetit dhe Tatim-Taksave.

Mbetet si detyrë mjaft e rëndësishme për të ardhmen gjetja e mënyrave dhe formave të tjera për të komunikuar me publikun për çështje si: diskutimi për buxhetin e bashkisë, paketës fiskale, tjetërsimit dhe dhënies me qira të pronave, zbatimi i standardeve e rregulloreve etj. me qëllim pjesëmarrjen aktive në vendimmarrje të komunitetit, ku çdo këshilltar për aktet normative, të cilat do të diskutohet dhe vendoset në këshill, të marrë opinionet dhe vërejtjet publike në lagjen ose fshatin që ata përfaqësojnë me qëllim që vendimmarrja të jetë në shërbim të komunitetit.

Gjatë mbledhjeve të Këshillit Bashkiak këshilltarët kanë shprehur kërkesa dhe ankesa të qytetarëve të zonave që përfaqësojnë të cilat i janë parashtruar ekzekutivit dhe janë diskutuar më tej për të marrë zgjidhje rast pas rasti.

Për vitin 2023 buxheti I Këshillit Bashkiak plani ishte 9.048.016 lekë dhe është realizuar n4.402.750 lekë ose 48,6% ose

Për sa më sipër ju falenderojmë secilin për kontributin e dhënë dhe ju ftojmë të jepni mendimet dhe sugjerimet tuaja për përmirësimin e punës së këshillit.

SEKRETAR

Etleva YZO

KRYETARI KËSHILLIT

Merita Isaraj

